

RREGULLORJA E NXËNËSVE viti 2012-13

1. Hyrje

Janë dy kritere për një qëndrim të qetë dhe produktiv në liceun Elektroteknik “Don Bosko”: sjellja korrekte dhe respektimi i rregullave dhe arritjeve shkollore.

Bashkëpunimi dhe respekti reciprok i të gjithë komponenteve shkollore (mësimdhënësit, nxënësit, personeli jo-mësimdhënës, prindërit) janë parakusht thelbësorë për të garantuar suksese më të mirë.

Shembulli më i mirë i secilit, sjelljeja në përputhshmëri me parimet e formuluar, është konsideruar metoda më e mirë e mësimnxënies.

2. Sjelljet brenda Qendrës Don Bosko

- Shkolla hapet në ora 7.30; porta mbyllet në ora 07.55..
- Orët mësimore zhvillohen nga ora 8,00 deri në ora 14.30; nga ora 15.00 deri në 15.45 është koha e studimit të organizuar ose e aktiviteteve kulturore.
- Hyrja në klasë nuk do të lejohet pasi të kalojnë 5 minuta pas rënies së ziles së dytë, megjithatë mund të hyhet në klasë në orën e dytë. Nxënësit që vonohen duhet t’i arsyetojnë mungesat në librezën personale nga koordinatori i tyre. Me norma nuk lejohet hyrja në klasë pas orës së dytë.
- Profesori duhet t’i regjistrojë në ditarin e klasës të gjithë nxënësit që vonohen; ata duhet të sjellin arsyetimin në librezën personale të firmosur nga koordinatori.
- Hyrja në klasat e veçanta, në laboratore dhe në punëtori lejohet vetëm më praninë e profesorëve.
- Ndalohet rreptësisht ngrënja apo pijet në amebntet e Labortaorit ose Sallave të veçanta.
- Sillni librat dhe pajisjet e nevojshme për shkollë; çdo nxënës është përgjegjës për gjërat e tij;
- Ndalohet pirja e duhanit brenda dhe jashtë Qendrës Don Bosko.
- Ndalohet vjedhja . Vjedhja do të dënohet me përjashtim të menjëhershëm nga shkolla.
- Duhet të jeni të kujdesshëm për pastërtinë e vetes tuaj dhe për shkollën, mos bëni rrëmujë dhe mos hidhni letra e bidona uji nëpër tokë...
- Pranoni pozitivisht këshillat dhe korrigjimet nga ana e përgjegjësve dhe edukatorëve/profesorëve.
- Përdorni një të folur korrekt dhe me edukatë.
- Jini të bashkuar dhe të respektueshëm më njëri-tjetrit: mos u shtrini nëpër bankat jashtë, mos u ulni në prehërin e njëri-tjetrit...
- Është e ndaluar të sillen armë, thika apo mjete të tjera që mund të shkaktojnë më të keqen, çdo nxënës automatikisht perjashtohet.
- Keni kujdes për pastërtinë dhe rendin e vetes suaj, ndalohet ardhja në shkollë të veshur në mënyrë jo të mirë (**provokative**)
- Mos i prishni materialet e të tjerëve.
- Të mos u bëhen dhurata e as festa personale profesorëve dhe përnërësve të Stafit; Ata nuk duhet të pranojnë dhurata apo diç tjetër nga nxënësit.
- Në fund të vitit shkollor është dita e mirënjohjeve dhe falenderimeve. Mirënjohja e vërtetë është angazhimi i secilit, si ajo e profesorëve po ashtu edhe e nxënësve, duke bërë mirë detyrën tuaj.

- Largimi nga Qendra, duke kaluar mbi rrethoja apo duke falsifikuar librezën personale, do të denohet me suspendim ose edhe me largim nga Qendra Don Bosko.
- Asnje nxënës nuk do të pranohet në Laborator ose salla të veçanta të mësimit nese nuk ka mjetet e nevojshme (literaturë , fletore, etj) pa pëlqimin paraprak të profesorit

3. Sjellja brenda klasëve të shkollës

- Mbani vendet e caktuara nga kujdestari i klasës.
- Mos lëvizni nëpër klasë.
- Mos flisni kurdo që doni dhe mos krijoni konfuzione.
- Daljet për në banjo dhe për nevoja personale bëhen me marrëveshje absolute me profesorin e orës përkatëse.
- Notat janë vendim i profesorit.
- Korrigjimi i detyrave bëhet për të thelluar njohurit në lëndën përkatëse dhe jo vetëm për të komunikuar notën.
- Mbani qetësi gjatë orëve të mësimit. Mund ta merrni fjalën vetëm atëherë kur u jep leje profesori dhe duhet të flisni me radhë;
- Mos u tallni me kolegun që gabon;
- Nuk duhet lëshuar klasën gjatë orëve të mësimit, një gjë e tillë lejohet vetëm në rastet urgjente dhe me lejen e profesorit.
- Profesori është përgjegjës për nxënësit gjatë orëve të mësimit. Në fund të orës mësimore, do të jetë profesori ai që do të thotë se ora ka përfunduar.
- Është e ndaluar të përdoret telefoni celular gjatë orëve të mësimit dhe gjatë pushimeve të shkurtëra pas çdo ore. Telefoni celular, i cili do të përdoret jashë vendit dhe jashtë kohës, do të mirret menjëherë dhe do t’u ipet vetëm prindërve.
- Të respektohen klasat, labororet, pajisjet dhe ambientet.
- Ndalohet prishja e inventarit , prishja e laboreve, zhdukja e pajisjeve, në të kundertën do të paguhet nga nxënësit.
- Pushimi i gjatë është vetëm pas orës së tretë të shkollës.
- Shkuarja në bar është e lejueshme vetëm pas orës së tretë (gjatë pushimit të gjatë).
- Gjatë ndërrimit të profesorëve, në pesë minutat e pauzës, nxënësit mbesin në klasë, çdo kërkesë i bëhet profesorit që hynë në orë;
- Përfundimi i orëve mësimore shenjohe me rënien e ziles; vetëm atëherë nxënësit dhe profesorët mund të lëshojnë klasat.
- Nxënësit të cilët gjatë gjithë orës mësimore janë të pa interesuar (ose pengoin procesin) duhet të verifikohen dhe të qortohen.

4. Libreza personale

- Libreza personale merret çdo fillim viti shkollor dhe duhet të jetë e firmosur (nënshkruar) nga prindërit.
- Kërkesat dhe arsyetimi i mungesave, hyrjet pas kohe dhe dajlet parakohe duhet të shkruhen në hapësirën përkatëse të librezës dhe duhet të jenë të nënshkruara nga prindërit (me përjashtim të rasteve kur fëmiju/nxënësi ka një kujdestarë të autorizuar për kujdesin ndaj ketij fëmiju/nxënësi).
- Në rastet e humbjes së librezës personale duhet të lajmëroheni menjëherë në sekretari dhe tek koordinatori juaj.
- Dhënia e një libeze në zëvendësim të asaj që është e papërdorshme më apo të asaj që e kemi humbur, duhet të bëhet me kërkesë të shkruar apo përmes telefonatës nga ana e prindërve të nxënësit, si dhe me pagesën paraprake e shumës së përcaktuar nga Këshilli i Institutit.

- Libreza e kompletuar duhet të dorëzohet në sekretari dhe do të jetë pjesë e portofolit personal për secilin vit shkollor

5. Arsyetimi i mungesave

- Mungesat arsyetohen nga koordinatori juaj.
- Familja kujdeset që të lajmërojë kujdestarin, sepse kështu shkruhet në ditarin e klasës, kur mungesat e vazhdueshme janë tashmë të parashikueshme (p.sh.: shtimi në spital, etj.)
- Në rast të mungesave të shumta apo të përsëritura periodikisht, kujdestari dhe profesorët do ta lajmërojnë koordinatorin, i cili pastaj do t'ia komunikojë familjes këtë gjë.
- Kërkesa për arsyetim të mungesave për më shumë se pesë ditë, në rast të semundjeve, duhet të plotësohet me certifikatë mjekësore që deklaron shërim të plotë.
- Nxënësi pa arsyetim pranohet në orë me rezervë dhe ai duhet të sjellë arsyetimin të nesermen. Nëse kjo nuk ndodhë, ose nëse poërsëritet, nxënësi mund të mos pranohet në orë dhe për këtë lajmërohet familja.

6. Lejimi i hyrjeve të vonuara dhe daljeve të më hershme

- Kërkesa për dalje të më hershme nga ana e prindërve, normalisht, duhet të bëhet deri në orën e fundit të mëngjesit (me disa përjashtime). Çdo autorizim për dalje duhet të jipet nga drejtori.
- 7. Në rastet e veçanta dhe/ose në rrethana të paparashikuara në të cilat është e mundur të zhvillohet mësimi i rregullt, klasat mund ta ndryshojnë orarin e tyre dhe të autorizohen për hyrje të mëvonshme apo dalje të më hershme. Familjet do të lajmërohen paraprakisht nëpërmes komunikimit në librezën personale.

8. Raportet shkollë – familje

- Orari i qëndrueshmërisë në Qendrën Don Bosko është nga ora 07.45 deri në ora 15.45. Prindërit të cilët duan që fëmija i tyre të kthehet në shtëpi pas orarit shkollorë të mëngjesit, duhet të plotësojnë modulin i cili merret në sekretari dhe të bëjë kështu kërkesën si për tërë vitin ashtu edhe për një pasditë të vetme.
- Komunikimi shkollë-familje bëhet nëpërmes librezës personale të nxënësit, për t'iu transmetuar prindërve komunikimin, informacionet lidhur me kalendarin shkollor, orarin mësimor, takimet e këshillit të klasëve dhe afatet e aktiviteteve didaktike.
- Nëse vlerësimet e shkruara dërgohen në shtëpi duhet të kthehen të nënshkruara për pranim; sepse ato janë dokumente të rëndësishme të vlerësimit të cilat duhet të merren me kujdes dhe të kthehen shpejtë.
- Çdo njëri që hyn në strukturën shkollë është i thirrur të sillet me përgjegjësi në çdo moment, me respekt dhe mirëkuptim për të drejtat e të gjithëve, me vullnetin që të bashkëpunojë me personelin e shkollës dhe me drejtorinë.
- Prindërit duhet të jenë prezent në mbledhje (patjetër , përndryshe përgjigjësia do të jetë e tyre.)

9. Sëmundjet e papritura

- Në rast të sëmundjeve të papritura të nxënësit shkolla jep ndihmën e parë dhe aktivizohet për ta lajmëruar familjen. Nxënësi, edhe nëse është i rritur, mund të kthehet në shtëpi vetëm nëse shoqërohet nga një familjar (autorizimi përmes telefonit konsiderohet i mjaftueshëm vetëm në rastet e veçanta).

10. Shërbimi i sekretarisë

- Qasja e nxënësve në sportelin e sekretarisë është e lejuar vetëm gjatë kohës së caktuar (në pushimin e gjatë) ose pas përfundimit të orëve mësimore.
- Te kihet kujdes me testet (mund të jenë duke u fotokopjuar)

11. Masat disiplinore

- Të gjitha shënimet disiplinore miratohen nga Drejtori.
- Nëse vërehet sjellje jo korrekte, drejtoria në marrëveshje me profesorët e këshillit të klasëve, do të përcjellë, sipas normave, këto praktika: vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, komunikim shkollë-familje, suspendim. Në çdo rast kur të jetë kryer krimi apo mund të ketë rreziqe për sigurinë e personave dhe për çfarëdo arsye tjetër emergjente, do të mblidhet menjëherë këshilli i klasave për të vendosur për masat disiplinore që duhet të ndërmerren. Në fund të suspendimit, nxënësi do të pranohet në orë vetëm nëse është i shoqëruar nga prindërit.
- Për çdo ankesë kundër sanksioneve disiplinore është kompetent Drejtori me Këshilli i Institutit, si organ i sigurisë së brendshme.

12. Biblioteka

- Nxënësit mund të kenë qasje në bibliotekë gjatë kohës së caktuar (gjatë pushimit të gjatë);

13. Literatura

- Tekstet e përshtatura mund të blihen në sekretari prej gjatë muajit shtatorit.

14. Parkimi i mjeteve të transportit

- Mjetet e transportit që mund të lejohen brenda Qendrës Don Bosko janë vetëm ato të profesorëve.